

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE  
FARMACOM SHPK**

Sot, më datë 20.02.2020 (dymijë e njëzetë), në praninë personale të Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë:

**Z.Ertel Kërçuku**, shtetas shqiptar, i biri i Ymer dhe i Baftisha, i datëlindjes 26.06.1978, banues në Kavajë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me nr.031031851.

Nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë tregtare FARMACOM SHPK, me kushtet si vijon:

**NENI 1  
Emri i shoqërisë**

- 1.1.Emri i shoqërisë do të jetë FARMACOM SHPK.
- 1.2.Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

**NENI 2  
Forma e shoqërisë**

- 2.1.Forma e shoqërisë tregtare FARMACOM SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).
- 2.2.Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3  
Selia e shoqërisë**

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet ne Tiranë, ne adresen: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.8, Rruga Paralele, Ndertese Private, Zona Kadastrale Nr.2105, Nr. Pasurie 1166/26-1, Kashar, Tiranë.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4  
Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.



## **NENI 5**

### **Objekti i veprimtarisë**

5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të :

- Shitj-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësorë. Import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore, etj.
- Investime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësorë.
- Ndërmjarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme konçesionare, privatizimi apo tenderimi.
- Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo shërbimi tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë pa u kufizuar në objektin e mësipërm të veprimtarisë.

## **NENI 6**

### **Kapitali i Shoqërisë**

- 6.1. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) lekë.
- 5.2. Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij në vlerën 100 (njëqind) lekë.
- 5.3. Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku i vetëm themelues në total dhe do të shlyhet prej tij.

## **NENI 7**

### **Organet Drejtuese**

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë:


1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

## **NENI 8**

### **Administrimi**

8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.



- 8.2. Administratori i Shoqërisë “FARMACOM” SHPK është **Z.Ertel Kërçuku**, shtetas shqiptar, i biri i Ymer dhe i Baftisha, i datëlindjes 26.06.1978, banues në Kavajë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me nr.031031851.
- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

**NENI 9**  
**Ligji i aplikueshëm**

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe parashikimet e Statutit të nënshkruar nga Ortaku Themelues.

**NENI 10**  
**Regjistrimi**

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**NENI 11**  
**Dispozitat përfundimtare**

- 11.1 Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues.

**ORTAK THEMELUES**

**Z. Ertel Kërçuku**

Ertel Kërçuku

